



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 151, datë 30.07.2018

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “AKSIONER INTERNATIONAL
SECURITIES BROKERAGE” SH.A. PËR TËRHEQJEN NGA USHTRIMI I
VEPRIMTARISË SI AGJENT I BROKERIT TË LETRAVE ME VLERË I SHOQËRISË
SË BROKERIMIT “SAXOBANK”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 47, pika 4 e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, vendimit nr. 55, datë 30.03.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Aksioner International Securities Brokerage” sh.a. për tërheqjen nga ushtrimi i veprimtarisë si agjent i brokerit të letrave me vlerë i shoqërisë së brokerimit “Saxobank”.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI